

ENVER MUHAMETI

## NOVATORIZMI — RRUGË E PASURIMIT TË MËTEJSHËM TË TRADITËS \*

Në procesin e gjatë të zhvillimit historik të letërsisë veprimi i ligjit të mohimit shprehet në atë raport dialektik që krijohet midis traditës dhe novatores, raport që nënkupton mohimin e disa anëve të caktuara të traditës dhe zhvillimin e pasurimit e mëtejshëm të elementeve të saj më pozitive, lindjen mbi bazën e tyre të së resë në art.

Novatorizmi i vërtetë që pasuron traditën tonë letrare qëndron në radhë të parë në pasqyrimin e brendisë së re të shoqërisë sonë në zhvillim të pandërprerë. Kjo nuk mund të arrihet pa përvetësimin e ndërgjegjshëm dhe krijues të elementeve pozitive dhe të gjalla të traditës së kaluar, pa i plotësuar dhe përsosur më tej ato në përputhje me kërkesat e reja të kohës.

Siç dihet, për traditën tonë letrare, veçanërisht që nga epoka e Rilindjes, ka qenë karakteristike shpirti patriotik e militant, lidhja e ngushtë me problemet e rëndësishme të jetës së popullit, mbështetja në folklor, ndjenja e përgjegjësisë qytetare për fatet e vëndit, urrejtja për armiqtë etj. Këto tipare themelore të traditës së letërsisë sonë përparimtare të së kaluarës janë formuar mbi bazën e dy lëvizjeve të mëdha historike të popullit shqiptar: të lëvizjes për çlirim dhe afirmim kombëtar si dhe të luftës për çlirimin shoqëror të popullit tonë, për zhvillimin demokratik të shoqërisë shqiptare.

Në mvartësi nga origjinaliteti i periudhave të zhvillimit historik të vëndit, nga pozita klasore dhe botëkuptimi i shkrimtarëve, idetë qendrore të letërsisë sonë, si ideja e patriotizmit dhe e karakterit të saj popullor kanë fituar tiparet e tyre specifike, nga njëra periudhë në tjetrën, janë thelluar ose pasuruar me veçori të reja dhe janë shprehur në forma e në shkallë të ndryshme. Në krijimtarinë letrare të fazës së parë të Rilindjes mbizotëron fryma e përgjithshme patriotike, e cila shprehet në hymnizimin nga shkrimtarët e virtyteve heroike të shqiptarëve ndër shekuj, në dashurinë për atdheun e për gjuhën shqipe, në admirimin për traditat dhe folklorin e pasur të popullit tonë, çka nxiti mbështetjen e vetëdijshe dhe krijuese në të të poetëve më të shquar të Rilindjes. Kurse për fazën e dytë të Rilindjes, nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX, me diferencimin e lëvizjes patriotike për shkak të pozitave të kundërta politike që zinin grupet e forcat e ndryshme shoqërore brenda lëvizjes dhe me ardhjen në letërsi të disa shkrimtarëve nga radhët e shtresave demokratike siç qenë Çajupi, Asdreni, Grameno, Noli etj. për letërsinë tonë bëhet karakteristike fryma demokratike, patriotizmi popullor, urrejtja për klasat e pasura që ishin bërë pen-

gesë për çlirimin e përparimin e kombit. Në vitet 20-30 me zhvillimin dhe forcimin e lëvizjes demokratike të masave dhe përhapjen e ideve komuniste thellohet më tej fryma demokratike e kombëtare e letërsisë sonë të lidhur me këtë lëvizje. Tipar themelor i saj bëhet pasqyrimi i problemeve të mprehta shoqërore të kohës, interesimi për gjendjen e shtresave të varfëra të popullit duke zbuluar dhe shkaqet social-ekonomike të kësaj gjendjeje. Shkrimtarët e rrymës demokratike revolucionare e shtruan edhe teorikisht nevojën e një letërsie me frymë popullore e tipare kombëtare. Për realizimin e kësaj detyre ata ndoqën parimin realist të pasqyrimin të jetës, që mbështetet në kuptimin historik të fenomeneve të jetës shoqërore.

Triumfi i revolucionit popullor dhe futja e vendit tonë në rrugën e ndërtimit socialist përcaktuan lindjen dhe formimin e një letërsie të re, e cila për zgjidhjen e detyrave të saj nuk mohoi traditat më të mira të letërsisë përparimtare ekzistuese, veçanërisht frymën patriotike, karakterin popullor dhe realizmin e saj, por i ruajti dhe i zhvilloi më tej ato, duke i pasuruar me një përmbajtje të re, socialiste. Në qendër të kësaj letërsie u vu populli, lufta dhe përpjekjet e tij për ndërtimin e jetës së re. Në përputhje me ligjin specifik të letërsisë, sipas të cilit veçoritë tipike të jetës sociale jepen përmes shfaqjeve të saj individuale, masat e popullit në përgjithësi pasqyrohen nga shkrimtarët tanë jo si diçka amorfe dhe e papërcaktuar, por kryesisht nëpërmjet krijimit të figurave të karaktereve shoqërore me tiparet e tyre individuale. Njëkohësisht në përpjekjet për të pasqyruar heroizmin masiv dhe rolin e popullit si forcë lëvizëse e procesit të ndërtimit socialist, letërsia jonë ka krijuar traditën e re të pasqyrimin të portretit kolektiv të masës, ku skenat masive e tabllotë e gjera epike të realitetit shkrihen organikisht me skenat që zbulojnë fatin individual të karaktereve. Pasqyrimi i rolit të ri historik të popullit si zot i fateve të veta, kuptimi dhe vlerësimi i luftës dhe i jetës së tij për krijimin e shoqërisë së re nga pozitat e partishmërisë proletare, në dritën e idealit socialist — përbën atë të re që sjell realizmi socialist në pasqyrimin e masave të popullit.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i karakterit novator të letërsisë sonë të realizmit socialist është trajtimi i heroit pozitiv si një ndër rrugët kryesore për mishërimin e drejtpërdrejtë të idealit socialist. Në krijimin e figurave të heronjve pozitivë letërsia jonë e re ka krijuar një traditë të çmuar. Stavri Lara i romanit «Kënetë» të F. Gjatës dhe Din Hyka, i romanit «Përsëri në këmbë» të Dh. Xhuvanit, komisari Memo i romanit omonim të D. Agollit, Adnani i romanit «Juga e bardhë» të J. Xoxës, apo Qemal Orhanaj i romanit «Para agimit» të Sh. Musarajt e shumë të tjerë, përgjithësojnë secili në mënyrën e tij mendimet, ndjenjat dhe synimet e njeriut më të përparuar të kohës së vet, interesat dhe aspiratat më të larta të popullit. Pavarësisht nga format e ndryshme të pasqyrimin të heroit të ri në letërsinë e shoqërisë socialiste, ai me tiparet thelbësore të karakterit të tij përfaqëson tipin social më të përparuar të kohës dhe përbën një shprehje të koncentruar individuale të veçorive të marrëdhënive shoqërore të një periudhe të caktuar historike. Në këtë kuptim çdo kohë ka heronjtë e vet, me tiparet karakteristike të kohës. Tiparet themelore të heronjve të epokës sonë janë tiparet që ka rrënjësuar tek ata lufta për ndërtimin e

socializmit: fryma e kolektivizmit dhe e vetmohimit socialist, besnikëria ndaj interesave të partisë e të popullit, patriotizmi socialist i lidhur me vendosmërinë për të mbrojtur e forcuar fitoret e revolucionit, fryma e optimizmit dhe e qëndrueshmërisë revolucionare, aftësia për të kapërcyer çdo pengesë në rrugën për realizmin e idealit, fryma e urrejtjes klasore dhe e papajtueshmërisë ndaj çdo shfaqjeje të ideologjisë së huaj etj. Në këto tipare të reja të heroit qëndron dhe karakteri i tij novator.

Duke e pasqyruar heroin pozitiv në luftë me çdo gjë që pengon ecjen përpara të revolucionit tonë, duke pasqyruar procesin e luftës së të resë me të vjetrën në shoqëri e në ndërgjegjen e njerëzve, letërsia pasqyron në të njëjtën kohë dhe kontradiktat e kohës. E reja që sjell realizmi socialist në pasqyrimin e kontradiktave është shtrimi dhe zgjidhja e tyre nga pozitrat e botëkuptimit marksist-leninist.

Këto janë disa nga traditat e reja që ka krijuar letërsia jonë e re gjatë rrugës së saj tridhjetëvjeçare. Mbështetja në këto tradita është një nevojë e domosdoshme e shkrimtarit të vërtetë, të lidhur ngushtë me interesat e popullit dhe një premisë për pasurimin e traditës me vlera të reja. Largimi që vihet re në disa krijime letrare të viteve të fundit nga tradita e shëndoshë e letërsisë sonë të kaluar e të sotme, duke iu shmangur trajtimit të problemeve të rëndësishme shoqërore të kohës, e duke u mbyllur në temën intime është shprehje e ndikimit të letërsisë moderniste, e nënvleftësimit të traditave të krijuara nga letërsia jonë dhe e konceptit që e sheh novatorizmin në letërsi të shkëputur nga përpjekjet për të pasqyruar realitetin tonë socialist.

Novatorizmi i letërsisë sonë mbështet në metodën e realizmit socialist. Shkrimtarët tanë kanë krijuar e po krijojnë vepra që e thellojnë parimin realist socialist të pasqyrimin të jetës, që i riprodhojnë karakteret në përputhje me ligjësitë e brendshme të zhvillimit të tyre, të përcaktuara nga marrëdhëniet shoqërore të vendit dhe kohës së tyre duke dhënë njëkohësisht dhe perspektivën ligjësore të zhvillimit. Veçanërisht në vitet 60 kur veprimtaria revolucionare e masave të udhëhequra nga partia u zgjerua e u bë më e vetëdijshme, kur pjekuria politike dhe ideologjike e partisë sonë u ngrit në një shkallë më të lartë dhe kur botëkuptimi i shkrimtarëve u bë më i qartë e më i thellë, vihet re njëkohësisht edhe një thellim i karakterit socialist të letërsisë sonë, një lidhje më e ndërgjegjshme e saj me interesat e revolucionit dhe rrjedhimisht edhe një pasqyrim më i thellë i proceseve themelore të transformimit revolucionar të shoqërisë sonë mbi bazën e kuptimit konkret-historik të ligjeve objektive të zhvillimit të saj. Bëhet më e theksuar prirja pozitive për të bërë sinteza e përgjithësime të gjera mbi rrugën e zhvillimit historik të popullit tonë mbi jetën tonë, mbi njerëzit tanë pa i shkëputur ata nga rrethanat konkrete në të cilat luftojnë.

Mirëpo në disa krijime letrare nga mosnjohja e thellë e jetës dhe formimi i pamjaftueshëm ideologjik të bie në sy një farë dobësimi i lidhjeve dhe i bashkëveprimit reciprok të karaktereve dhe rrethanave të jetës së tyre. Veprimet, tiparet, kthesat e personazheve të këtyre krijimeve nuk motivohen sa duhet nga pikëpamja sociale e psikologjike, nuk shpjegohen mbi bazën e kushteve në të cilat ata janë formuar. Kuptohet se shfaqje të tilla nuk japin mundësi të zbulohet thelbi

novator i jetës sonë, sferat e reja të saj. Ato nuk përputhen me metodën e realizmit socialist, e cila si një parim i ri i pasqyrimit artistik të jetës që mbështetet në botëkuptimin marksist-leninist presupozon jo «zbehje të realizmit për hir të formave të reja», por ngritjen e tij në një fazë cilësorisht të re, një pasqyrim më të thellë, besnik e të shumanshëm nga pozitat e socializmit shkencor të karaktereve në lidhje të ngushtë me marrëdhëniet e jetës shoqërore, pjella e të cilave ata janë. Kjo është në traditën e letërsisë sonë të realizmit socialist. Një nga arësyet kryesore që personazhet e veprave më të mira të kësaj letërsie janë bindës e jetësorë qëndron në faktin se përgjithësimi në to buron nga situata konkrete tipike, se personazhet e tyre janë njerëzit tanë që veprojnë në kushtet konkrete të shoqërisë sonë, që jetojnë me problemet e shqetësimet e saj. Të largohesh nga kjo traditë e shëndoshë do të thotë të mos krijosh vlera të reja letrare, të mos pasqyrosh transformimet reale të shoqërisë sonë, të njerëzve tanë, por një botë abstrakte e njerëz në përgjithësi. Nëse letërsia e sotme moderniste ka hequr dorë plotësisht nga realizmi, kjo ndodh sepse ajo ka humbur çdo lidhje me jetën reale dhe me traditat më të mira të artit botëror. Shkëputja krejtësisht nga realiteti shoqëror duke i përqëndruar përpjekjet vetëm në formë dhe mohimi i realizimeve ideo-artistike pozitive të epokave të mëparshme nuk mund të sjellë asgjë me të vërtetë të re, veç absurditeteve të reja, veç krijimeve formaliste e abstraksioniste pa kuptim që nuk mund të quhen art në kuptimin e vërtetë të fjalës, deri sa cënojnë ligjet specifike të zhvillimit artistik.

Siç dihet, letërsia historikisht progresive për nga përmbajtja e vet ideore është në radhë të parë produkt i kushteve historiko-shoqërore të jetës së një populli. Në përmbajtjen e vet specifike dhe në format që i përshtaten asaj ajo kultivon para së gjithash ato parime të kuptimit e vlerësimit të veçorive karakteristike të jetës që lindin në vetëdijen ideologjike të shoqërisë në shkallë të ndryshme të zhvillimit të saj historik si pasojë e ndryshimit progresiv të marrëdhënieve shoqërore. Por në të njëjtën kohë letërsia zhvillohet edhe mbi bazën e zbulimit, përvetësimit dhe përpunimit të vazhdueshëm të parimeve të veta krijuese, të parimeve të tipizimit të jetës për të shprehur një vlerësim të caktuar ideo-emocional të saj. Ajo ka, pra, edhe zhvillimin e vet të brendshëm, ligjet e veta specifike të zhvillimit. Nga kjo pikëpamje letërsia përbën një pasuri të madhe formash, mënyrash dhe parimesh të riprodhimit figurativ të realitetit shoqëror. Burimi kryesor i përmbajtjes së saj është njohja e drejtpërdrejtë ideo-emocionale e jetës, letërsia e transformon dhe e shpreh këtë përmbajtje në gjuhën e vet specifike. Në këtë proces ajo krijon atë arsenal mënyrash e formash të shprehjes artistike dhe parimesh të pasqyrimit figurativ që përbëjnë traditën, trashëgiminë e saj të veçantë. Krijimtaria letrare e çdo epoke në jetën e një populli nuk mund të zhvillohet më tej, nuk mund të pasurohet pa përvetësimin krijues të kësaj tradite artistike kombëtare e botërore, që i ka qëndruar kohës.

Kështu një nga parimet më të njohura të tipizimit të jetës në letërsinë epike, parimi i thurrjes e organizimit të subjektit, që zbulon marrëdhëniet midis personazheve të një vepre e që shpreh një përmbajtje të caktuar ideore është produkt i një zhvillimi të gjatë historik, në procesin e të cilit ai është zhvilluar, pasuruar e ngritur në një shka-

llë më të lartë. Nga njëra epokë në tjetrën, në letërsinë e rrymave të ndryshme letrare të vendeve të ndryshme kanë lindur gjithmonë subjekte të reja, parime të reja të thurjes së tyre. Por ky evoluim i subjekteve letrare dhe i parimeve të ndërtimit të tyre është bërë kryesisht mbi bazën e përpunimit dhe të pasurimit të mëtejshëm të parimeve ekzistuese të letërsisë epike, të traditës pozitive kombëtare e botërore të grumbulluar në këtë drejtim e jo duke injoruar këtë traditë. Në qoftë se letërsia moderniste e ka mohuar subjektin, duke i këputur kështu lidhjet me një element vital të traditës, kjo është pasojë e tendencës për ta shkëputur letërsinë nga jeta, nga realiteti shoqëror i kohës, për ta bërë atë të pakuptueshme për masat, rezultat i heqjes dorë nga krijimi i figurave artistike, i futjes së personazheve të vetmuar, të sëmura patologjikisht ose të mbyllur në guackën e tyre, rezultat i mohimit të rolit njohës dhe edukues të artit.

Letërsia jonë epike si dhe gjinitë e tjera të saj ka traditën e vet edhe në këtë aspekt të formës. Përmbajtja e këngëve popullore epike, e rapsodive të ndryshme, e tregimeve dhe poemave më të mira epike të shkrimtarëve të Rilindjes organizohej nëpërmjet subjektit, naracionit. Mjete të tjera të organizimit të mendimit në poezinë tonë popullore e të kultivuar kanë qenë rima, ritmi, aliteracioni etj. Tipar karakteristik i formës së kësaj poezie ka qenë figuracioni i thjeshtë dhe i qartë, detajet konkrete etj. Të gjitha këto mjete e forma nuk i kanë penguar këngëtarët tanë popullore dhe poetët tanë më të mirë si Naimi, De Rada, Noli, Migjeni etj. të arrijnë në përgjithësime të rëndësishme artistike. Asnjëri prej tyre nuk mohoi arritjet pozitive të mëparshme, por i zhvilloi e i pasuroi më tej ato në përshtatje me idetë e reja, me përmbajtjen e re që do të shprehte. Kjo pasuri mjetesh dhe formash e zhvilluar historikisht, e mbështetur dhe në traditën përparimtare botërore në pajtim me kërkesat dhe shijet estetike të popullit tonë është zhvilluar e pasuruar më tej nga shkrimtarët tanë të realizmit socialist në funksion të pasqyrimin të dinamikës së jetës sonë socialiste. Është e qartë se pa përvetësimin krijues të kësaj pasurie formash e mjetesh shprehëse artistike nuk mund të krijohen forma të reja, të afta të shprehin në mënyrë më adeguate përmbajtjen e re të jetës. Niveli i sotëm i poezisë sonë të realizmit socialist nuk mund të arrihej pa përvetësimin e traditës së pasur të poezisë patriotike, demokratike e revolucionare të së kaluarës.

Mirëpo ndonjëherë në disa krijime të letërsisë epike e dramatike vihet re një farë largimi nga këto tradita, siç është mohimi i subjektit dhe zëvendësimi i tij me asociacione të rastit e me një konvencionalizëm të tepruar. Derisa letërsia epike e dramatike pasqyron në radhë të parë marrëdhëniet sociale të njerëzve, ngjarjet e jetës së tyre, veprimet, lëvizjet e thëniet e tyre, atëhere kuptohet se subjekti si mjet për zbulimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve reciproke midis personazheve të një veprë nuk mund të mos jetë një element i rëndësishëm i formës artistike të veprave të letërsisë epike e dramatike, një mjet që jep dorë për të krijuar tabllo të gjera epike të realitetit tonë, për të pasqyruar marrëdhëniet e shumanshme të karaktereve, zhvillimin e tyre, për të riprodhuar madhështinë e transformimeve të rëndësishme, revolucionare që ndodhin në jetën e në ndërgjegjen e njerëzve të shoqërisë sonë. Sigurisht është pa kuptim të përcaktohet masa e subjektit apo

të kanunizohen parimet e organizimit të tij, parime që përsosen vazhdimisht. Do të ishte e dëmshme gjithashtu të mendohej se nuk mund të krijohen lloje të tjera të letërsisë që të mos kenë nevojë për subjektin në se këtë e kërkon pasqyrimi me vërtetësi i realitetit tonë, apo se lloji i poemës liriko-epike të lëvruar gjerësisht tek ne e që përgjithësisht nuk ka subjekt është mohim i traditës letrare në këtë fushë. Përkundrazi ajo është përtëritje e formës artistike të këtij lloji që ka ekzistuar edhe më përpara. Por në të njëjtën kohë nuk do t'i sillte aspak dobi zhvillimit të letërsisë epike heqja dorë nga subjekti deri sa ai, siç dëshmon përvoja e letërsisë epike përparimtare botërore si dhe veprat më të mira të letërsisë sonë epike e dramatike, ndihmon të pasqyrohen me besnikëri e në zhvillimin e vet marrëdhëniet e shumanshme të njerëzve tanë, veçoritë karakteristike të jetës së tyre, që përbëjnë objektin kryesor të artit. Vërshimi i vrullshëm i jetës së re në letërsi kërkon natyrisht dhe forma të reja të shprehjes artistike. Por krijimi i tyre arrihet jo duke flakur format tradicionale, por mbi bazën e tyre nëpërmjet përsosjes dhe ripërtëritjes së tyre.

Krahas procesit të pasurimit të traditës me vlera të reja ideo-artistike zhvillohet edhe procesi i mohimit të elementeve të saj të vjetëruar. Ky është ose mohimi ideologjik i asaj përmbajtjeje që nuk pajtohet me idealet e shoqërisë sonë, ose mohim i atyre formave dhe mjeteve shprehëse që janë produkt i një botëkuptimi idealist e metafizik, shprehje e drejtpërdrejtë e asaj përmbajtjeje që mohohet. Teoria marksiste-leniniste është kundër mohimit metafizik që shkatërron e flak të vjetrën pa dallim, ajo është për mohimin krijues dialektik të traditës. Një mohim i tillë është ligj i zhvillimit të mëtejshëm e i pasurimit të traditave, i progresit të artit, i novatorizmit të vërtetë. Ai përmban gjithmonë momentin e lidhjes së të resë me të vjetrën. E reja mbron jo gjithë të vjetrën, por vetëm anët e saj negative që pengojnë zhvillimin dhe ruan e zhvillon më tej, mbi një bazë të re, gjithshka me vlerë që ka arritur e vjetra. Në këtë mënyrë e vjetra, në trajtën e anëve të saj pozitive, vazhdon të ruajë ekzistencën e saj duke u transformuar në të rene, duke iu nënshtruar ligjeve të zhvillimit të së resë. Pikërisht kuptimi i drejtë i brendisë dialektike të mohimit si lidhje e së resë me të vjetrën, si mohimi i elementeve të saj negative dhe ruajtje e zhvillim i mëtejshëm i anëve të saj pozitive qëndron në bazën e raportit midis traditës e novatorizmit. Kështu në poezinë tonë të sotme, në përgjithësi, ashtu si edhe në poezinë patriotike e demokratike të paraqitimit rregullat e formës poetike transformohen e vihen në funksion të shprehjes së përmbajtjes së re të jetës, ato përshtaten në përputhje me kërkesat e kësaj përmbajtjeje. Letërsia jonë në tërësi u është shmangur disa elementeve të vjetëruar të epikës sonë tradicionale si këngë të tëra me përshkrime fragmentare ambientesh e veprimesh, me lënie testamentesh e duele, me episode e rrethana të izoluara, pasazhe me hollësira jetësore të parëndësishme etj. Disa nga këto elemente të vjetëruar tashmë të traditës, si stoli të tepërta që nuk përputhen me përmbajtjen e re të realitetit tonë të pasqyrimin në një farë mënyrë jetuan si për inerci në disa krijime me temë historike nga epoka e Skënderbeut si dhe në disa poema epike të viteve '50.

Letërsia, si një formë specifike e ndërgjegjes shoqërore dhe e kulturës shpirtërore të shoqërisë, para së gjithash si fushë specifike e ideologjisë është pasqyrim i zhvillimit të jetës shoqërore të njerëzve, i veçorive të saj karakteristike. Për këtë arsye ndryshimet cilësore që ndodhin në jetën shoqërore të njerëzve vjen një kohë që gjejnë shprehjen e vet edhe në letërsi.

Një hop cilësor në zhvillimin socialist të vendit tonë, veçanërisht në fushën e ideologjisë e të kulturës shënuan transformimet që u bënë në vitet '60. Ky hop cilësor në jetën tonë u reflektua edhe në letërsi e në art. Por vlerat e reja letrare-artistike që u krijuan në këtë fazë të re të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste ishin rezultat i zhvillimit dhe i pasurimit të krijimtarisë letrare-artistike ekzistuese, vazhdim logjik i saj. Prandaj është krejt e gabuar e metafizike pikëpamja sipas së cilës letërsia e një dekade të mëvonshme, që të jetë novatore duhet të mohojë letërsinë e dekadës së mëparshme. Në të vërtetë po t'i hidhet qoftë edhe një vështrim i shpejtë historisë së zhvillimit të letërsisë sonë nuk është e vështirë të vihet re se gjithë krijimtaria letraro-artistike përparimtare e popullit tonë dhe e shkrimtarëve që u kanë shërbyer interesave të tij, gjatë gjithë periudhave të rëndësishme të historisë sonë kombëtare përbën një proces vazhdimësie dialektike, një tërësi të vetme ku çdo periudhë e mëvonshme për zgjidhjen e detyrave të kohës ka përvetësuar e shfrytëzuar me kujdes gjithshka pozitive që ka krijuar periudha e mëparshme, ku çdo shkrimtar i mëvonshëm kurrë nuk është ngritur, nuk është bërë shprehës i aspiratave të popullit të vet pa asimiluar trashëgiminë e tij letrare-artistike të mëparshme, gjithë kulturën e tij shpirtërore përparimtare.

Po nëse kjo vazhdimësi është e vërtetë për letërsinë e periudhave të paraqirimit, që megjithë hallkat që i bashkojnë, kanë ndryshime të rëndësishme nga njëra-tjetra, atëherë a mund të vihet ajo në dyshim për letërsinë e realizmit socialist, që në të gjitha etapat e saj është udhëhequr nga e njëjta ideologji dhe është zhvilluar në thelb si letërsi e shoqërisë socialiste, pavarësisht nga tiparet e reja që fiton në çdo etapë? Nga kjo pikëpamje nuk ka bazë mendimi se poetët e prozatorët e rinj duhet të thyejnë «kanonet», të ndryshojnë gjendjen ekzistuese në letërsi, duke mos marrë asgjë nga tradita e mëparshme. Një mendim i tillë që nuk sheh vazhdimësinë dialektike të periudhave të zhvillimit të letërsisë sonë, që i sheh ato të shkëputura nuk merr parasysh se etapat e ndërtimit të shoqërisë sonë socialiste, refleksi të cilave është letërsia, janë vazhdim i njëra-tjetrës, rezultat i zhvillimit e i thellimit të veprimtarisë së Partisë. Lidhur me nevojën e ndryshimeve cilësore që duheshin bërë në letërsi e në art për të kapërcyer prapambetjen e krijuar për shkak të ndryshimeve të vrullshme cilësore që kishin ndodhur e po ndodhin në realitetin tonë shoku Enver ka thënë: «Këto ndryshime nuk duhet të bëhen duke mohuar trashëgiminë artistike të realizmit tonë socialist, ashtu si ndryshimet cilësore në realitetin tonë nuk u bënë duke mohuar veprimtarinë e partisë dhe të popullit për ndërtimin e socializmit»<sup>1</sup>.

1) Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1967-68, f. 484.

Kjo vazhdimësi e fazave të zhvillimit të letërsisë sonë të realizmit socialist nuk përjashton që letërsia e një faze të mohojë disa anë të vjetëruara të traditës letrare të fazës së mëparshme. Përkundrazi, mohimi ka karakter të përgjithshëm, ai shoqëron çdo proces zhvillimi. Veçse mohimi krijues, dialektik nuk është absolut, ai presupozon medemos trashëgiminë, ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të anëve pozitive, që janë baza e realitetit tonë dhe rrjedhimisht edhe karakteristika themelore e letërsisë sonë.

Kështu letërsia e viteve 60, nën ndikimin e fuqishëm të transformimeve revolucionare që ndodhën në jetën e botëkuptimit e njerëzve asimiloi arritjet më të mira të letërsisë së etapës së mëparshme, ruajti e zhvilloi më tej boshtin, palcën e kësaj letërsie, partishmërinë proletare dhe frymën popullore, shpirtin luftarak e qytetar, patriotizmin socialist, mbështetjen në krijimtarinë e pasur popullore dhe tipare të tjera pozitive, karakteristike për letërsinë e viteve 50. Nga tradita e artit tonë të realizmit socialist gjithnjë diçka mohohet e vjetrohët jo vetëm kur kalohet nga njëra etapë në tjetrën, por edhe brenda çdo etape. Këto janë ato elemente të kësaj tradite që pengojnë zhvillimin e vërtetë novator të artit tonë, dobësi e të meta të përmbajtjes ideore, ndikime të huaja, moderniste e konservatore dhe elemente të formës artistike që nuk përputhen me përmbajtjen e re të realitetit tonë socialist. Kjo është një rrugë e natyrshme zhvillimi e ripërtëritjeje.

Letërsia jonë zhvillohet, thellon përmbajtjen e saj socialiste dhe frymën popullore e kombëtare në luftë me çdo lloj ndikimi të huaj. Në tërësinë e saj, në të gjitha etapat e zhvillimit të vet ajo është një letërsi e re, e përshkuar nga ideologjia marksiste-leniniste. Janë pa baza e metafizike ato teorizime që kanë synuar t'i kundërvënë njëra-tjetrës etapat e zhvillimit të letërsisë sonë të re që nga fillimet e saj e gjer në ditët tona.

Tradita letrare kolektive e viteve 50 është sintetizuar e transformuar në traditën më të re të viteve 60. Është plotësisht e natyrshme që tradita e viteve 60 për zgjidhjen e detyrave të saj ideo-artistike të mbështetëj para së gjithash në atë trashëgimi të afërt, (në krijimtarinë letrare-artistike të viteve '40-'50), që sintetizon rezultatet e stadeve më të hershme të zhvillimit letrar-artistik të popullit tonë.

S'ka dyshim se gjithë letërsia jonë e realizmit socialist që nga fillimet e saj në vitet e Luftës nacionalçlirimtare e deri në vitet '60 ka qenë në tërësinë e saj një letërsi novatore dhe socialiste. Në vartësi nga shkalla e përvojës dhe e talentit, nga brumosja ideologjike dhe njohja e jetës shkrimtarët tanë e kanë pasqyruar nga pozita e ideologjisë marksiste-leniniste luftën e masave popullore të udhëhequra nga partia kundër okupatorëve e klasave shfrytëzuese të vendit dhe përpjekjet për ndërtimin e jetës së re.

Përvetësimi krijues i traditës letrare-artistike pozitive është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të artit, për të krijuar një art të vërtetë novator. Shkrimtarët e shquar përparimtarë të së kaluarës si edhe shkrimtarët tanë më me përvojë u mësojnë vazhduesve të tyre të rinj jo vetëm mjeshtërinë profesionale, artin e pasqyrimin të jetës në figura artistike, por edhe si të kuptojnë më mirë, nëpërmjet studimit të së kaluarës së popullit veçoritë karakteristike të jetës së tij

të sotme. Veprat më të mira letrare-artistike përvetësohen jo për t'u bërë skllav i tyre, por për të njohur më mirë realitetin e sotëm për një pjesëmarrje më aktive në jetën ekonomike, politike, shoqërore e kulturele të vendit. Arti i vërtetë novator ka qenë gjithmonë dhe është para së gjithash pasqyrim i përmbajtjes së re të jetës së kohës, pjellë objektive e saj, shprehje e origjinalitetit shoqëror-historik të epokës që e ka lindur. Prandaj duke nënvizuar rolin e madh të traditave letrare në krijimin e një arti të ri, nuk duhet harruar roli përcaktues i jetës në këtë drejtim. Është pikërisht ai realitet në të cilin jeton e vepron shkrimtari si luftëtar i frontit ideologjik që e formon atë, që përcakton përmbajtjen e krijimtarisë së tij. Shkrimtari i pasqyron veçoritë karakteristike të jetës shoqërore të njerëzve tanë për të shprehur një interpretim e vlerësim ideo-emocional aktiv të karaktereve, një kuptim e vlerësim të nisur nga pozitat e botëkuptimit revolucionar të kohës. E reja në letërsi lindi si nevojë e brendshme e shkrimtarit për një përgjithësim të ri më të thellë, më të gjerë të shfaqjeve tipike të jetës që zhvillohet për t'iu përgjigjur nevojave e kërkesave të reja ideo-estetike të masave. Por pa vëzhguar e studjuar me vëmendje, nga pozitat e botëkuptimit marksist-leninist, tiparet, shprehitë e zakonet e reja që lindin në jetën e njerëzve tanë, pa ndjekur hap pas hapi jetën e popullit, pa jetuar me aspiratat e shqetësimet e tij është e pamundur që shkrimtari t'u përgjigjet kërkesave të reja të masave, të jetë kështu vazhdues i traditës, krijues i vlerave të reja letrare. Përvetësimi i trashëgimisë letrare i nënshtrohet gjithmonë zgjidhjes së detyrave të reja të jetës, krijimit të shoqërisë së re socialiste. Vetëm duke iu nënshtuar këtij qëllimi traditat fitojnë jetë të vërtetë. Të mbështetesh në traditat do të thotë të përvetësosh me sy kritik e të shfrytëzosh në mënyrë krijuese gjithë përvojën artistike përparimtare dhe në radhë të parë atë kombëtare për të realizuar një detyrë novatore konkrete, një pikësynim ido-artistik që u përgjigjet tendencave themelore progresive të shoqërisë sonë, të kohës sonë, të krijosh pra një vlerë të re ideo-artistike që sintetizon organikisht gjithçka më të mirë që është krijuar më parë. Në procesin e krijimtarisë së shkrimtarit traditat dhe novatorizmi janë të shkrira në një të vetme. Shkrimtari i vërtetë është njëkohësisht edhe novator edhe vazhdues i traditave të caktuara, kryesisht i traditës kombëtare.

Mbështetja në radhë të parë në trashëgiminë kulturele-artistike përparimtare kombëtare është një premisë e domosdoshme për të krijuar një art të vërtetë novator e origjinal kombëtar me frymë popullore e përmbajtje socialiste. Forcimi i karakterit kombëtar të letërsisë duke asimiluar nga pozitat e partishmërisë proletare kulturën shpirtërore të popullit tonë të formuar gjatë shekujve si rezultat i rrethanave të veçanta social-historike të jetës së tij është edhe një mjet efikas për të luftuar me sukses ndikimet e huaja borgjeze-revizioniste që janë bërë më të theksuara këto vjetët e fundit në letërsinë e në artet tona e për të edukuar masat me frymën e besnikërisë ndaj çështjes së socializmit.

Në kushtet e sotme të ashpërsimit të luftës ideologjike, nënvleftësimi sado i vogël i traditave tona të shëndosha kombëtare do të sillte mbivlerësimin e kulturës e të artit borgjez e revizionist, zëvendësimin e traditës kombëtare me traditën e huaj, gjë që do të ishte zhdukje

e frymës kombëtare origjinale e novatore të letërsisë e të artit tonë. Në këto kushte çështja e raportit midis traditës dhe novatorizmit mund të zgjidhet duke u nisur nga pozitat e partishmërisë proletare e cila mbështetet në njohjen e ligjeve objektive të zhvillimit të shoqërisë dhe të artit.

Arti i vërtetë i kohës sonë që mbështetet fort në njohjen e këtyre ligjeve është arti i realizmit socialist. Prandaj vetëm arti që përshkohet në çdo ind të tij nga botëkuptimi marksist-leninist, që është i lidhur ngushtë me interesat e popullit e i shërben atij duke shfrytëzuar për këtë qëllim gjithçka të mirë që është krijuar në të kaluarën, është art i vërtetë novator që pasuron vlerat letrare-artistike kombëtare dhe botërore njëkohësisht.

### R é s u m é

#### L'INNOVATION

#### CHEMIN DE L'ENRICHISSEMENT DE LA TRADITION

C'est en traitant la question de la juste compréhension du rapport entre la tradition et l'innovation que l'auteur Enver Muhameti souligne la nécessité impérieuse de s'assimiler de façon créative littéraire et artistique progressiste le passé, et en tout premier lieu celui national, comme une prémisse absolument nécessaire à créer un véritable art novateur et d'esprit national.

L'auteur souligne que nos hommes de lettres contemporains, appuyés sur la principe du réalisme socialiste, ont développé et porté à un niveau plus élevé les meilleures traditions littéraires et artistiques du peuple albanais, en les enrichissant d'un nouveau contenu socialiste et en donnant naissance à plusieurs traditions nouvelles.

E. Muhameti critique l'opinion qui n'envisage pas la continuité dialectique des périodes de développement de nos lettres du réalisme socialiste et qui sous-estime l'esprit novateur des lettres des années 50. Il souligne à ce propos que: «Cette continuité n'exclut pas que la littérature d'une phase nie quelques aspects vieillis de la tradition littéraire de la phase antérieure. Il s'agit d'influences idéologiques, esthétiques, modernistes et conservatrices étrangères, qui entravent tout à tour la révolutionnarisation ultérieure de notre art, sa mise au service de l'éducation révolutionnaire de classe des masses populaires. Mais la littérature est novatrice dans toutes les étapes de son développement, empreinte par l'idéologie marxiste-léniniste et intimement liée aux intérêts populaires».